



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT
TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 3332 Prot.

Tiranë, më 16.9.2021

Lënda: Raporti i monitorimit të performancës së produkteve të buxhetit të ILDKPKI, për 8- mujorin e vitit 2021.

Drejtuar: **Z. Oltjon MUZAKA**
NËPUNËS I PARË AUTORIZUES
MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË

TIRANË

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në zbatimin e buxhetit të shtetit për 8-mujorin e vitit 2021, është mbështetur në kërkesat më të domosdoshme institucionale, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, "Për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, të Detyrimeve Financiare të të Zgjedhurve dhe të Disa nëpunësve Publikë", i ndryshuar, Ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike", i ndryshuar, parandalimit dhe goditjes së korrupsionit në sektorin publik e privat nëpërmjet hetimit administrativ të sinjalizimit të brendshëm e të jashtëm dhe mbrojtjes së individëve që sinjalizojnë për veprime dhe praktika të dyshuara të korrupsionit nga hakmarrja në përputhje me Ligjin nr.60/2016, datë 2.6.2016, "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", i ndryshuar, duke paraqitur një realizim të shpenzimeve buxhetore për këtë periudhë, si më poshtë vijon;

Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në mbështetje të Ligjit nr.137/2020 "Për buxhetin e vitit 2021" dhe të Udhëzimit nr.9, datë 30.03.2018 "Për Procedurat Standarte të Zbatimit të Buxhetit", i është akorduar një fond buxhetor prej **157 milion e 99 mijë e 520 lekë**, i cili përbëhet nga:

Fondi i Pagave: 102 milion e 860 mijë lekë (zëri 600)

Fondi i Sigurimeve Shoqërore: 15 milion e 400 mijë lekë (zëri 601)

Fondi për Shpenzime Operative: 35 milion e 100 mijë lekë (zëri 602)

Fondi për Investime: 3 milion lekë (zëri 231)

Transferime korrente: 739 mijë e 520 lekë (zëri 606)

Buxheti i akorduar për programin “*Menaxhim, Administrim, Planifikim*”, është i mbështetur në Deklaratën e Politikës të hartuar gjatë procesit të PBA 2021-2023, për realizimin e misionit të ILDKPKI, i cili kërkon një menaxhim efektiv të fondeve buxhetore të akorduara, në funksion të përcaktimit të rregullave për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë, të legjitimitetit të burimeve të krijimit të saj, detyrimeve financiare për të zgjedhurit, nëpunësit publikë, për familjarët e tyre dhe për personat e lidhur me ta, si edhe të garantojë një vendimmarrje të paanshme, transparente, në interesin më të mirë të mundshëm të publikut e të besimit të tij ndaj Institucioneve publike, nëpërmjet parandalimit të konfliktit ndërmjet interesave publike dhe atyre private të zyrtarëve në ushtrimin e funksioneve të tyre, si dhe parandalimin dhe goditjen e korrupsionit në sektorin publik dhe privat.

Inspektorati i Lartë, për 8 – mujorin e vitit 2021, në realizimin e shpenzimeve buxhetore është mbështetur në një shpërndarje sa më racionale të kërkesave, në harmonizimin e nevojave të ILDKPKI, me burimet financiare në dispozicion, në funksion të përmirësimit tërësor të infrastrukturës institucionale, me qëllim rritjen e cilësisë së kontrollit të interesave private dhe zbatimin e politikave buxhetore përmes përdorimit ekonomik dhe eficient të burimeve financiare, për realizimin e objektivave prioritare si;

- Drejtimi dhe përmirësimi i politikave dhe mekanizmave për kontrollin e vërtetësisë dhe saktësisë së pasurive, të parandalimit dhe shmangies së konfliktit të interesave të zyrtarëve që ushtrojnë funksione publike, si instrumente të rëndësishme për luftën kundër korrupsionit.
- Forcimi i mëtjshëm i teknikave të hetimit administrativ jo vetëm në identifikimin e pasurive të fshehura apo të padeklaruara, por sidomos në kryerjen e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm të rasteve të konfliktit të interesave.
- Hetimi mbi pasuritë dhe burimin e të ardhurave të personave jo zyrtarë që kanë interesa të përbashkëta me subjektin deklarues dhe forcimi i punës për zbulimin e rasteve të fshehjes apo deklarimit të rremë të zyrtarëve që abuzojnë me pushtetin.
- Parandalimi i rasteve të pasurimit në rrugë abuzive të zyrtarëve dhe të personave të lidhur me ta.
- Parandalimi i rasteve të konfliktit rast pas rasti apo të vazhdueshëm të interesave të zyrtarëve që ushtrojnë funksione publike.
- Penalizmi i rasteve të abuzimit nga zyrtarët me funksionet e tyre publike.
- Parandalimi dhe goditja e korrupsionit në sektorin publik e privat nëpërmjet hetimit administrativ të sinjalizimit të brendshëm e të jashtëm dhe mbrojtjen e individëve që sinjalizojnë për veprime dhe praktika të dyshuara të korrupsionit nga hakmarrja në përputhje me ligjin nr. 60/2016, datë 2.6.2016 “*Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*”, i ndryshuar.

Nga fondi i përgjithshëm buxhetor, në zbatim të Ligjit nr.137/2020 “*Për buxhetin e vitit 2021*”, për periudhën e raportuar, Inspektorati i Lartë ka realizuar vlerën buxhetore në vlerën 94,547,895.59 lekë ose 84.70 %, të fondit të planifikuar për 8- mujorin e vitit 2021.

Llog Ek	Përshkrimi	Plan-Buxheti vjetor 2021	Plan-Buxheti vjetor i ndryshuar 2021	Plan-Buxheti 8-mujor 2021	Buxheti I realizuar 8-mujor 2021	Realizimi në % si 8-mujor
600	Fond Page	102.860,00	102.860,00	70.360,00	65.594,63	93,23%
601	Kontrib.Sig Shoq & Shënd	15.400,00	15.400,00	10.600,00	9.756,46	92,04%
602	Shpenzime operative	35.100,00	35.100,00	27.010,00	17.412,29	64,47%
606	Transferta per financime te tjera	240,00	739,52	659,52	509,52	77,26%
231	Investime	3.000,00	3.000,00	3.000,00	1.275,00	42,50%
Shuma		156.600,00	157.099,52	111.629,52	94.547,90	84,70%

✦ **Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore** (zëri 600-601)

Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore është realizuar në zbatim të strukturës organizative të miratuar. Për 8-mujorin e vitit 2021 numri i punonjësve është realizuar 70 vetë, nga 70 vetë të miratuar.

Me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.1151 datë 24.12.2020, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2021, në njësitë e qeverisjes qendrore”, për shkak të nevojave të institucionit, është miratuar një punonjës me kontratë të përkohshme deri në fund të vitit 2021.

Fondi i përgjithshëm i pagave dhe i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për këtë periudhë, është realizuar për numrin faktik të punonjësve në vlerën 65,594,629 lekë ose 93,23% e fondit të planifikuar për periudhën respektive dhe për kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 9,756,457 lekë ose 92,04%, e fondit të planifikuar për periudhën respektive.

✦ **Fondi për shpenzime në zërin investime** (zëri 231)

Gjithsej fondi i planifikuar i investimeve për vitin 2021, është 3,000,000 (tre milion) lekë të miratuar si produkte nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me objekt “Blerje Sistem Audio Prezantimi” me fond limit 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekë me tvsh, “Blerje Pajisje Elektronike” me fond limit 1,340,000 (një milion e treqind e dyzet mijë) lekë me tvsh dhe “Blerje Pajisje të Tjera Zyre” me fond limit 160,000 (njëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë me tvsh, të cilat do të prokurohen në mbështetje të Regjistrimit të Parashikimeve të Prokurimeve Publike për periudhën respektive gjatë vitit 2021.

1. Fondi i planifikuar i investimit i miratuar si produkt nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me objekt “Blerje Sistem Audio Prezantimi” me fond limit 1,250,000 (një milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa tvsh është realizuar me procedurën e blerjes “Kërkesë me propozim”, me Urdhër Prokurimi nr.2596 prot., datë 14.4.2021 dhe është fituar nga operatori ekonomik “LUAR BROS” sh.p.k në vlerën 1,062,500 (një milion e gjashtëdhjetë e dy mijë e pesëqind) lekë pa tvsh ose 85% e fondit të planifikuar. Likujdimi është kryer në zbatim të detyrimeve të kontratës dypalëshe nr.2892 datë 3.6.2021.

2. Fondi i planifikuar i investimit të miratuar si produkt nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me objekt "*Blerje Pajisje Elektronike*" me fond limit 1,116,667 (një milion e njëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh, ishte në proces prokurimi me procedurën "Procedurë e hapur e thjeshtuar" sipas Urdhër Prokurimi nr.3035 prot. datë 25.6.2021, bazuar në Ligjin nr.162/2020 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin publik", Neni 98, pika 1, germa b, u anulua me Urdhër Anullimi nr.3035/3 dt.14.7.2021.
Aktualisht është në proces prokurimi me procedurën e blerjes "Procedurë e hapur e thjeshtuar", sipas Urdhër Prokurimi nr. 3158 Prot, datë 14.7.2021 me fond limit 1,340,000 (një milion e treqind e dyzet mijë) lekë me tvsh ose 1,116,667 (një milion e njëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh, në zbatim të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, si dhe akteve ligjore të nxjerra në zbatim të tij.

Fondi për shpenzime në zërin Mallra dhe Shërbime (zeri 602)

Realizimi për grupin e shpenzimeve operative për 8- mujorin e vitit 2021 është gjithsej në vlerën 17,412,289.59 lekë me tvsh ose 64,47% e fondit të planifikuar për këtë periudhë, duke respektuar dispozitat ligjore në fuqi.

Për 8-mujorin e vitit 2021 realizimi në grupin e shpenzimeve operative është mbështetur duke respektuar dispozitat ligjore në fuqi. Diferencat në vlerë përbëjnë kursime gjatë procesit të prokurimit, të cilat janë rishpërndarë sipas nevojave më të domosdoshme të institucionit.

1. Shërbimi i ruajtjes me roje civile është vazhdim i Marrëveshjes Kuadër nr. 1935 prot, datë 30.4.2020, me operatorin ekonomik me kapital shtetëror "*Illyrian Guard*" sh.a, në mbështetje të Vendimit nr.177, datë 4.4.2019 "*Për krijimin e Shoqërisë "Illyrian Guard" sh.a dhe për përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të kësaj shoqërie*, me objekt "*Shërbimi i ruajtjes me roje civile*" për godinën e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 muaj, nga momenti i nënshkrimit të marrëveshjes (3.5.2020-3.5.2021). Është likujduar marrëveshja kuadër në përputhje me parashikimet ligjore, konkretisht në 4-mujorin e parë të vitit 2021 u bë likujdimi në vlerë 999,998 (nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë me tvsh e cila mbyll dhe detyrimin total të kësaj marrëveshje kuadër. Sa më sipër, për fondin e parashikuar për grup artikullin "*Shërbimi i ruajtjes me roje civile*" për godinën e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, për periudhën në vazhdim është lidhur marrëveshja kuadër nr. 2743 prot., datë 30.4.2021, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 muaj, nga momenti i nënshkrimit të marrëveshjes (afati i zbatimit të kontratës 4.5.2021-3.5.2022). Likujdimi për periudhën e shërbimit të kryer, është në vlerën 987,379 (nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e treqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë me tvsh, në zbatim të detyrimeve të kontratës dypalëshe.

2. Fondi “*Mirëmbajtje dhe shërbime software (sistemi HIDAACI)*”, është vazhdim i kontratës nr. 2968 prot., datë 2.11.2020 me BOE, “*IkubINFO sh.p.k & Infosoft Systems sh.p.k*”, me procedurën e prokurimit “Tender i Hapur”, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 48 muaj nga momenti i nënshkrimit të kontratës. Likujdimi për 8-mujorin e vitit 2021, për mirëmbajtjen dhe shërbimin e kryer është likujduar në vlerën 8,083,332 (tetë milion e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e dy lekë) lekë pa tvsh ose 9,699,998 (nëntë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë me tvsh, në zbatim të detyrimeve të kontratës së lidhur konform specifikimeve teknike të kërkuara.
3. Fondi i parashikuar për grup artikullin “*Blerje materiale pastrimi*”, me fond limit për 416,667 (katërqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh, është realizuar me procedurën e blerjes me vlerë të vogël dhe është fituar nga operatori ekonomik “*XH-N-SH GROUP*” sh.p.k në vlerën 412,000 (katërqind e dymbëdhjetë mijë) lekë pa tvsh ose 99% e fondit të planifikuar. Likujdimi është kryer konform specifikimeve teknike të kërkuara.
4. Fondi i parashikuar për grup artikullin “*Blerje materiale kancelarie*”, me fond limit për 666,667 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh, është realizuar me procedurën e blerjes me vlerë të vogël dhe është fituar nga operatori ekonomik “*Infosoft Office*” sh.p.k në vlerën 661,000 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e njëmijë) lekë pa tvsh ose 99% e fondit të planifikuar. Likujdimi është kryer konform specifikimeve teknike të kërkuara.
5. Fondi i parashikuar për grup artikullin “*Shërbim riparim/mirëmbajtje për 3 automjetet e ILDKPKI*”, me fond limit 583,333 (pesëqind mijë) lekë, pa tvsh, është realizuar me procedurën e blerjes me vlerë të vogël dhe është fituar nga shoqëria “*Auto Manoku Servis*” sh.p.k në vlerën 522,500 (pesëqind e njëzet e dy mijë e pesëqind) lekë pa tvsh ose 89,57% e fondit të planifikuar. Likujdimi është kryer konform specifikimeve teknike të kërkuara.

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar në përmbushjen e detyrimeve me shtetin si posta, energji, ujë, telefoni. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe janë lidhur kontrata shërbim i abonimit në shtyp, siguracione të detyrueshme për automjetet e ILDKPKI, kontrata e shërbimit të mirëmbajtjes së ashensorit, larjes së automjeteve, të cilat janë realizuar si procedura prokurimi me blerje me Vlerë të Vogël.

Përsa i përket shpenzimeve për blerje mallra të natyrave të ndryshme, institucioni ynë për këtë periudhë, i ka prokuruar dhe realizuar sipas nevojave konkrete, si dhe në mbështetje të dispozitave ligjore në fuqi.

Realizimi i prokurimeve të shpenzimeve të akorduara për ILDKPKI, për 8-mujorin e vitit 2021 është mbështetur në Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike të vitit 2021 dhe kërkesave konkrete të institucionit, të kërkesave për përmirësimin e mëtejshëm të

punës në menaxhimin dhe zbatimin e objektivave të përcaktuara, duke zbatuar me korrektësi të gjitha detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni financiar nëpërmjet një administrimi korrekt dhe kontrolli të vazhdueshëm.

Realizimi i të ardhurave nga veprimtaria e ILDKPKI

Të ardhurat nga veprimtaria e ILDKPKI, vijnë kryesisht nga;

1. Arkëtimi i gjobave të vendosura për rastet e shkeljes së detyrimeve ligjore, gjatë zbatimit të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 “Për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, të Detyrimeve Financiare të të Zgjedhurve dhe të Disa Nëpunësve Publikë”, i ndryshuar, ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike” i ndryshuar, ligjit nr.60/2016, datë 2.6.2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” i ndryshuar, nga subjekte në sektorin publik dhe privat. Për 8-mujorin e vitit 2021, janë gjithsej 29 raste të ekzekutuara me vullnet të lirë, në vlerën 3.960,000 (tre milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë.
2. Ekzekutimi i detyrueshëm nga Zyrat Përmbartimore të rretheve për gjobat e vendosura për rastet e shkeljes së detyrimeve ligjore, si dhe vendimeve gjyqësore që kanë marrë formë të prerë. Për këtë periudhë janë ekzekutuar tërësisht gjithsej 36 raste, në vlerën 5,467,000 (pesë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë) lekë.

Gjithsej të ardhurat të arkëtuara për periudhën janar-gusht 2021, janë në vlerën 9.427.000 lekë.

Të gjitha këto të ardhura, të realizuara në zbatim të ligjeve organike mbi të cilat funksionon Inspektorati i Lartë dhe të VKM nr.432, datë 28.6.2006 “Mbi të ardhurat në Institucionet Buxhetore”, kanë kaluar në Buxhetin e Shtetit në masën 100%.

Menaxhimi efektiv i fondeve buxhetore të akorduara për ILDKPKI, në funksion të një vendimmarrje transparente në kontrollin e deklarimit të pasurive, legjitimitetin e burimeve të krijimit, detyrimeve financiare për të zgjedhurit, nëpunësit publikë, për familjarët dhe personat e lidhur me ta, nëpërmjet parandalimit të konfliktit të interesave të zyrtarit, në ushtrimin e funksioneve publike, si dhe arritja e standarteve më të mira, do të vazhdojë të jetë një faktor i rëndësishëm në realizimin e punës, në drejtim të shpenzimeve të miratuara vjetore për përmbushjen e qëllimit dhe objektivave institucionale.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
Arber BASHOLLI

